



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/05-1027920/24 më 30 SEP 2024

Kryetari i Kryeqytetit, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 4, nenin 7 dhe nenin 8 paragrafi 5 të Ligjit nr. 03/L – 139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L – 205 dhe nenin 83 të Ligjit nr. 05/L – 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet inicimi i procedurës së shpronësimit, sipas kërkesës së subjektit kërkues – Komuna e Prishtinës, për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme të pronarit dhe zotëruesit të interesit për pjesën e parcelës kadastrale nr. 427-64, me sipërfaqe prej:489m<sup>2</sup>, Zonën Kadastrale Çagllavicë, ku sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re Perendim” të Komunës së Prishtinës është planifikuar Infrastrukturë Rrugore, si dhe projektit të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për ndërtimin e Rr. “Nekibe Kelmendi” faza III.
2. Vlera e kompensimit të pronës së cekur në pikën 1, caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria e Pronës dhe Kadastrit, Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.
4. Mjetet financiare për kompensimin e shpronësimit do ti sigurojë subjekti kërkues – Komuna e Prishtinës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërën nga gazetatat me tirazh të madh.

Përparim Rama

Kryetar i Kryeqytetit



Iu dërgohet:

- Drejtorisë së Pronës dhe Kadastrit;
- Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave;
- Kabinetit të Kryetarit – Sektorit Ligjor;
- Qendrës për shërbim me qytetar.